



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KONSULTATIV I BIZNESIT**

---

---

**Mbledhja e Keshillit Konsultativ te Biznesit,**  
**E Hene, 16/07/2007, ora 11.00**

*Minutat e takimit*

Me date 16.07.2007 ora 11.00 prane ambjenteve te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes (METE) u zhvillua mbledhja e rradhes se Keshillit Konsultativ te Biznesit (KKB) duke ndjekur kete rend dite:

**Rendi i Dites:**

Diskutim lidhur me ndryshimet e Paketes Fiskale si me poshte:

- Per ndryshim ne Ligjin nr 7928 date 27.04.1995 “Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar”, te ndryshuar.
- Per ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr 8782 date 3.05.2001, “Per Shoqerite e Kursim- Kreditit”.
- Per ndryshim ne Ligjin nr 8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”, te ndryshuar.
- Per ndryshim ne Ligjin nr 8788 date 7.05.2001 “Per Organizatat jofitimpruese”
- Per ndryshim ne Ligjin nr 7892 date 21.12.1994 “Per Sponsorizimet”, te ndryshuar.

Mbledhja u kryesua nga Kryetari i KKB-se Z. Genc Ruli, Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, dhe moren pjese shumica e anetareve.

Ne kete mbledhje u prezantuan projekt ligjet perkatese duke komentuar ndryshimet te paraqitura nga Ministria e Financave. Z. Florjan MIMA, Zv.Minister i Financave, argumentoi nevojen e nderhyrjeve ne keto akte ligjore.

Pas diskutimit te anetareve te KKB, rreth propozimeve per keto ndryshime ne keto projekt akte ligjore, nga kjo mbledhje rezultuan keto sugjerime:

**1. Projekt ligji per ndryshimin e ligjit nr. 7928 date 27.04.1995 “Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar”, te ndryshuar.**

Per ndryshimin shkronjes “a” te nenit 26/1, lidhur me importimin perfundimtar te te gjitha mallrave prej nje personi te tatueshem, kur furnizimi i tyre, ne te gjitha rrethanat, brenda vendit eshte furnizim i perjashtuar nga TVSH dhe ky percaktim sipas kesaj shkronje nuk zbatohet per furnizim nga importi te periodikeve, revistave etj...., gjykojme se :

- Ky propozim eshte nje forme e paster subvencioni. Sipas Nenit 1 te Marreveshjes se OBT-se per Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese, eshte nje perjashtim nga taksat dhe konkretisht nga TVSH. Kjo forme subvencioni bie ne kundërshtim me kete Marreveshje sepse sipas nenit 2 te Marreveshjes, eshte subvencion specifik

sepse jepet per nje sektor te caktuar (tregtimi i librave, revistave, etj.) dhe sipas marreveshjes, subvencionet specifike jane te ndaluara.

- Gjithashtu kjo eshte nje forme e diskriminimit fiskal qe bie ndesh me nenin 21 te Marreveshjes Interim te Tregtise se Lire (MSA/Marreveshja Ad Interim), Shqiperi-BE e cila eshte nje marreveshje qe ne themel te saj ka parimet dhe dispozitat e marreveshjeve te OBT-se si dhe me nenin III te GATT “Trajtimi Kombetar ne taksimin dhe Rregullat e Brendshme”.

**Duke qene se eshte nje forme subvencioni e ndaluar, demton kushtet e konkurrences se drejte dhe per rrjedhoje shtremberon tregun vendas.**

- Gjithashtu edhe ne kendveshtrimin e ligjit te Ndhimes Shtetore, referuar nenit 4 te ketij ligji: “.....ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në gfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, shtrëmbëron ose kërcënon të shtrëmbërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara....”.

**Ne keto kushte formulimi i propozuar per shkronjen “a” nuk mund te qendroje.**

## **2. Projekt ligji per ndryshime dhe shtesa ne Ligjin NR 8782 date 3.05.2001, “Per Shoqerite e Kursim-Kreditit”.**

**Gjate diskutimit te ketij projekt ligji, nga te gjithë anetaret e KKB u konkludua qe neni 52 ekzistues i ligjit te mos shfuqizohet.**

Shoqerite e Kursim Kreditit, te vendosen ne kondita te barabarta me organizatat jofitimpruese qe operojne ne fushen e mikrokredive, nisur edhe nga fakti per kontributin qe ato japin lidhur me zhvillimin e zonave rurale.

Për këtë arsye, u theksua nga te gjithë anetaret se eshte e parakoheshme te vendoset per taksimin e shoqerive te kursim kreditit sepse:

- Ne baze te ligjit ekzistues ato percaktohen si shoqata jofitimpruese me baze vullnetarizimin. Pra koncepti i “fitimit” per keto shoqata nuk ekziston. Nje nderhyrje e tille do te sillte konflikt me ligjin “Per Shoqatat e Kursim Kreditit”
- Punojne me grupet e marxhinalizuara te shoqerise dhe jane akoma te mbeshtetura nga donatoret, etj.
- Nuk gjejme arsye, perse ato jane vecuar nga institucionet e tjera te mikrofinanses e OJF-te, duke deformuar tregun dhe duke i vene ne pozicion te diskriminuar ne lidhje me te tjeret (Besa, PSHM, MAFF, World Vision, etj).
- Keto shoqeri u krijuan mbi parimet e ligjit dhe cdo ndryshim ne mes te rruges do ta demtonte sistemin.

Duke marre ne konsiderate sa me siper, si edhe:

- Rolin e Unioneve per ofrimin e sherbimeve financiare njerezve me te ardhura te ulta,
- Keto shoqata u sherbejne ne rradhe te pare feremreve, pra pikerisht atij sektori ku sistemi bankar nuk ka hyre ende dhe aksesit ne financim eshte thuajse i paperfillshem;
- Perpjekjet e qeverise dhe Bankes Boterore per te ngritur kete sistemin,
- Kontributin indirekt te ketij aktiviteti per rritjen e taksave ne buxhet, si dhe

- Impaktin e dukshem ne zhvillimin e zones rurale;
- Shoqatat e kursim kreditit, numerojne rreth 26 mije anetare dhe japin nje kontribut te kenaqshem ne luftimin e varferise.

**mendojme se eshte e nevojshme qe te mos ndryshoje statusi fiskal i shoqerive te kursim kreditit, qe do te thote, te mos shfuqizohet neni 52.**

### **3. Projekt ligji per ndryshim ne Ligjin nr 8788 date 07.05.2001 “Per Organizatat jofitimpruresë”**

Ndryshimet e parashikuara ne kete projekt ligj hasen ne disa kundershime nga anetaret e KKB. Nje sygjerim lidhur me kete projekt ligj ishte ndryshimi qe duhet bere ne ligjin baze, ne menyre qe keto organizata te taten nese zhvillojne veprimtari ekonomike jashte veprimtarise se percaktuar ne statutin e tyre. Kështu, për Nenin 40 "Lehtesimi dhe perjashtimi nga detyrimet fiskale", propozojme kete riformulim te paragrafit te dyte te tij:

*"Te ardhurat e realizuara prej ketyre subjekteve nga veprimtari e mirefillte ekonomike qe nuk lidhet ne menyre direkte me ushrimin e aktivitete per te cilin ato jane krijuar, do te konsiderohen si te ardhura te ardhura nga veprimtari fitimpruresë qe i nenshtrohet aplikimit te tatimit perkates"*

### **4. Projekt ligji per ndryshim ne Ligjin NR 8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”, te ndryshuar.**

Lidhur me ndryshimet ne kete projekt ligj, nga anetaret e KKB, u ngrit problemi i zbatimit te ligjit te ri per “Turizmin”. Me ligjin e ri jane hequr te gjitha perjashtimet nga paketa fiskale. Lind e nevojshme te saktsohet se si do te trajtohen subjektet qe operojne ne fushen e turizmit, te cilet ne baze te ligjit te vjeter, kane perfituar statusin e personit te stimuluar ne turizem, duke saktësuar periudhen se per sa kohe do te vazhdojne te perfitojne kete status bazuar ne ligjin e vjeter per turizmin.

Për këtë arsye propozojme shtimin e nje paragrafi, si dispozite tranzitore per personat te cilet ligjerisht gezojne aktualisht titullin Person i Stimuluar ne turizem dhe perkatesisht dhe lehtesite tatimore qe burojne nga ky titull, dhe konkretisht:

*"Personat juridike apo fizike te cilet gezojne ne momentin e hyrjes ne fuqi te ketij ndryshimi nje titull te vlefshem si "Personit te Stimuluar per Veprimtari Turistike", dhe e ushtrojne e kete titull ne perputhje me dispozitat ligjore te aplikueshme, do te vazhdojne te gezojne lehtesite tatimore perkatese per gjithë afatin e kohezgjatjes se ketij titulli"*

### **5. Projekt ligji per ndryshimin e Ligjit NR 7892 date 21.12.1994 “Per Sponsorizimet”, te ndryshuar.**

Ndryshimet e parashikuara ne kete projekt ligj konsiderohen si pozitive dhe nuk pati kundershime.